

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 531, datë 28.8.2019

PËR

**FUNKSIONIMIN DHE MËNYRËN E ZHVILLIMIT**  
**TË VEPRIMTARISË SË DREJTORIVE RAJONALE**  
**TË TRASHËGIMISË KULTURORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 28, të ligjit nr.27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", të ligjit nr.90/2019, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", dhe të nenit 44, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Përcaktimin e funksionimit dhe të mënyrës së zhvillimit të veprimtarisë së drejtorive rajonale të trashëgimisë kulturore (në vijim, DRTK).
2. DRTK-të janë institucione rajonale të specializuara, tekniko-administrative buxhetore, në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, me seli në Tiranë, Shkodër, Vlorë, Korçë, Berat e Gjirokastrë. DRTK-të, për të kryer funksionet e tyre, monitorohen dhe koordinohen nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (në vijim, IKTK), si njësi përgjegjëse për mbarëvajtjen e tyre.
3. DRTK-të financohen nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera të ligjshme, sipas legjislacionit në fuqi.
4. DRTK-të kanë për mision gjurmimin, studimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin dhe publikimin e trashëgimisë kulturore për çdo territor që secila prej tyre administron.

5. Në territorin e Republikës së Shqipërisë ushtrojnë veprimtarinë 6 (gjashtë) DRTK, të cilat janë shpërndarë në territor sipas administrimit më të mirë të pasurive kulturore.
6. DRTK Tiranë ushtron veprimtarinë në këto qarqe:
  - a) Tiranë;
  - b) Durrës;
  - c) Dibër.
7. DRTK Shkodër ushtron veprimtarinë në këto qarqe:
  - a) Shkodër;
  - b) Lezhë;
  - c) Kukës.
8. DRTK Vlorë ushtron veprimtarinë në këto qarqe:
  - a) Vlorë;
  - b) Fier.
9. DRTK Korçë ushtron veprimtarinë në këto qarqe:
  - a) Korçë;
  - b) Elbasan.
10. DRTK Berat ushtron veprimtarinë në territoret, si më poshtë vijon:
  - a) Në Qendrën Historike Berat, pjesë e listës së trashëgimisë botërore të UNESCO-s, shpallur si e tillë me vendim të Komitetit të Trashëgimisë Botërore në vitin 2008;
  - b) Në Bashkinë Berat;
  - c) Në Bashkinë Ura Vajgurore;
  - ç) Në Bashkinë Kuçovë;
  - d) Në Bashkinë Skrapar;
  - dh) Në Bashkinë Poliçan.
11. DRTK Gjirokastrë ushtron veprimtarinë në territoret, si më poshtë vijon:
  - a) Në Qendrën Historike Gjirokastrë, pjesë e listës së trashëgimisë botërore të UNESCO-s, shpallur si e tillë me vendim të Komitetit të Trashëgimisë Botërore në vitin 2008;
  - b) Në Bashkinë Gjirokastrë;

- c) Në Bashkinë Libohovë;
- ç) Në Bashkinë Tepelenë;
- d) Në Bashkinë Memaliaj;
- dh) Në Bashkinë Përmet;
- e) Në Bashkinë Këlcyrë;
- ë) Në Bashkinë Dropull.

## **II. PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË DREJTORIVE RAJONALE TË TRASHËGIMISË KULTURORE**

DRTK-të kanë përgjegjësi të organizojnë punën për realizimin e detyrave dhe ushtrimin e përgjegjësive në fushën e trashëgimisë kulturore materiale lidhur me gjurmimin, studimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin dhe publikimin e trashëgimisë kulturore në territorin që administrojnë.

## **III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I DRTK-VE**

1. Struktura dhe organika e DRTK-ve miratohet me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.
2. DRTK-të funksionojnë në bazë të ligjit për trashëgiminë kulturore dhe muzetë, të këtij vendimi dhe të statutit të miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.
3. Statuti dhe rregullorja që përcaktojnë metodat e brendshme të punës për secilën DRTK miratohen nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore.
4. DRTK-të drejtohen e përfaqësohen nga drejtori, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e DRTK-së nën monitorimin e koordinimin e IKTK-së dhe përgjigjet para ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.
5. Drejtori i DRTK-ve emërohet dhe lirohet nga detyra nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Procedura e emërimit dhe e lirimit të tij përcaktohet në statutin e institucionit.
6. Drejtori i DRTK-ve duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme, si më poshtë vijon:

- a) Të ketë eksperiencë profesionale dhe të dokumentuar në fushën e trashëgimisë kulturore e të menaxhimit;
  - b) Nuk duhet të jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.
7. Kriteret e veçanta për emërimin e drejtorit të DRTK-së përcaktohen në statutin e DRTK-së.
8. Marrëdhëniet e punës së drejtorit e të punonjësve të DRTK-së rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.
9. DRTK-të realizojnë aktivitetin nën monitorimin e koordinimin e IKTK-së dhe në bashkëpunim me:
- a) institucionet e tjera në varësi të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore;
  - b) organet e administratës qendrore;
  - c) organet e vetëqeverisjes vendore;
  - ç) institucionet e tjera shkencore, kulturore, fetare, personat fizikë e juridikë për gjurmimin, evidentimin, studimin, konservimin, restaurimin, promovimin e publikimin e pasurive kulturore.
10. DRTK-të, në territorin përkatës që mbulojnë, kryejnë detyrat, si më poshtë vijon:
- a) Kryejnë verifikime sistematike apo në bazë të kërkesave të paraqitura për gjendjen e pasurive kulturore në territorin që administrojnë, si dhe ushtrojnë kontrollin teknik për kushtet e ruajtjes së pasurive kulturore, duke përfshirë edhe fondet muzeore, si dhe të zonave që u nënshtrohen dispozitave të mbrojtjes indirekte;
  - b) Kryejnë ndërhyrje, punime konservimi dhe restaurimi në pasuritë kulturore në bazë të projekteve të miratuara në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (në vijim, KKTKM);
  - c) Kryejnë mbikëqyrjen dhe kolaudimin e zbatimit të punimeve në pasuritë kulturore materiale, në përputhje me vendimin e KKTKM-së;
  - ç) Marrin në dorëzim punimet për ndërhyrjet në pasuritë kulturore të paluajtshme, përfshirë edhe tipologjitë e punimeve për konservim dhe restaurim fasade, konservim e restaurim të elementeve të brendshme artistike, ruajtje të vlerave arkeologjike kulturore;
  - d) Mbi bazën e deklarimeve të marra nga mbajtësi i pasurisë kulturore, njoftojnë IKRTK-në sipas parashikimeve të ligjit, në rast ndryshimi të vendndodhjes së pasurive kulturore të luajtshme, duke përfshirë edhe fondet muzeore në rastin e mbylljes së muzeve privatë;

- dh) Njoftojnë pronarët ose poseduesit për fillimin e procedurës së mbrojtjes indirekte;
  - e) Kryejnë kontrolle për zbatimin e detyrimeve ligjore lidhur me hapjen dhe shfrytëzimin nga publiku të pasurive kulturore, respektimin e kushteve të përcaktuara në aktin e tjetërsimit dhe detyrime të tjera të parashikuara në ligj;
  - ë) Kryejnë verifikimet e nevojshme në terren dhe i përcjellin zyrtarisht IKTK-së informacion në rastin e gjetjeve të konstatuara nga vetë DRTK-të ose të tjerë mbi bazën e konstatimeve ose të deklarimeve të marra për gjetje rastësore arkeologjike në territor ose gjatë zbatimit të projekteve;
  - f) Japin mendim lidhur me përputhshmërinë e vendosjes dhe të llojit të reklamimit me vlerat e peizazhit të ndërtimeve apo zonave, subjekt i mbrojtjes.
11. DRTK Berat dhe DRTK Gjirokastrë, si pjesë e listës së trashëgimisë botërore të UNESCO-s, në territorin që mbulojnë, përveç detyrave të përcaktuara në pikën 10, të këtij kreu, kryejnë edhe detyrat, si më poshtë vijon:
- a) Monitorojnë e administrojnë qendrat historike Berat e Gjirokastrë dhe sigurojnë ruajtjen e vlerës së veçantë universale të tyre;
  - b) Hartojnë raporte periodike për gjendjen e konservimit të pasurisë botërore në zbatim të vendimeve të Komitetit të Trashëgimisë Botërore;
12. Drejtori i DRTK-ve ka kompetencat, si më poshtë vijon:
- a) Është përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e objektivave të DRTK-së, në përputhje me politikën, programet e planet strategjike të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe misionin e DRTK-së;
  - b) Monitoron dhe kontrollon faktorët e riskut që vënë në rrezik arritjen e objektivave të DRTK-së;
  - c) Emëron e shkarkon punonjësit e DRTK-së në bazë të Kodit të Punës dhe statutit të DRTK-së;
  - ç) Planifikon, drejton e koordinon funksionimin e përgjithshëm të institucionit;
  - d) Drejton punën administrative të DRTK-së dhe përfaqëson institucionin në marrëdhënie me të tretët.
13. DRTK-të kanë logon dhe vulën e tyre zyrtare. Stema e DRTK-ve përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë me shënimet “Republika e Shqipërisë, Ministria e Kulturës, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (emri i qarkut apo i bashkisë ku ka selinë drejtoria)”, në

përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

14. Vula e çdo DRTK-je ka formën dhe elementët e përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, të administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **IV. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

1. Ngarkohen Ministria e Kulturës, DRTK-të, si dhe institucionet e tjera në fushën e trashëgimisë kulturore për zbatimin e këtij vendimi.
2. Deri në fillimin e funksionimit të plotë, të miratimit të strukturës dhe të organikës së DRTK-ve, sipas këtij vendimi, drejtoritë rajonale të kulturës kombëtare (DRKK) vazhdojnë që të kryejnë funksionet e tyre sipas strukturës dhe organikës në fuqi.
3. Struktura dhe organika e DRTK-ve miratohet me urdhër të Kryeministrit brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
4. DRTK-të do të kryejnë funksionet e inspektimit në territorin që mbulojnë deri në ngritjen e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Trashëgimisë Kulturore, në zbatim të ligjit për trashëgiminë kulturore e muzetë dhe ligjit për inspektimin.
5. Ngarkohet Ministria e Kulturës, në përputhje me ligjin nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të bëjë transferimin e fondeve buxhetore nga DRKK-të te DRTK-të.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

**KRYEMINISTRI**

**EDIRAMA**

MINISTRI I KULTURËS

EVA MARGARITI



NR.PROT. 4067/1  
DATË 30.8. 2019

MINISTRISË SË KULTURËS  
DREJTORIVE RAJONALE TË TRASHËGIMISË  
KULTURORE TIRANË, VLORË, SHKODËR, KORÇË,  
BERAT DHE GJIROKASTËR  
QENDRË SË BOTIMEVE ZYRTARE

**Sekretari i Përgjithshëm**

**Engjell AGAÇI**

**Në mungesë dhe me porosi**

**Elira KOKONA**

